



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*

*Ministria e Tregtisë dhe Industrisë*  
*Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry*



Agjencia Kosovare e Standardizimit  
Kosovo Standardisation Agency  
Kosovska Agencija za Standardizaciju

**Raport i realizimit të planit të punës**  
**AKS 2018**

**Planifikimi i planit të punës**  
**AKS 2019**

**Përmbajtja:**

1. Roli dhe rëndësia e standardizimit
2. Korniza ligjore e AKS
3. Këshilli Profesional i Standardizimit (KPS)
4. Komitetet Teknike (KT)
5. Standardet e adoptuara
6. Standardet e shfuqizuara
7. Standardet e shitura
8. Aktivitetet promovuese të AKS
9. Sistemi SMIS dhe ueb faqja e AKS
10. Buxheti i AKS
11. Grupe punuese/komisione
12. Raporte/kërkesa/takime
13. Trajnimet
14. Ngecjet në realizimin e aktiviteteve
15. Sfidat e standardizimit kosovar
16. Planifikimi i planit të punës AKS 2019

## **1. Roli dhe rëndësia e standardizimit**

Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS), është institucion i cili siguron platformë për zhvillimin e standardizimit, duke mbështetur cilësinë dhe sigurinë e produkteve, proceseve dhe shërbimeve si dhe përhapjen e njohurive përmes standardeve, të cilat në mënyrë të vazhdueshme i zhvillon/adopton/miraton duke i dhënë prioritet atyre që kërkohen nga palët e interesit dhe që kanë më shumë ndikim në zhvillimin ekonomik të Kosovës. AKS zhvillon Standarde Kosovare për të gjitha palët e interesit dhe punon së bashku me rreth 150 ekspertë të fushave të ndryshme të cilët aktivizohen në Këshillin Profesional të Standardizimit dhe në Komitete Teknike.

## **2. Korniza ligjore e AKS**

Baza ligjore e AKS ka ekzistuar, megjithatë për të rritur nivelin e efikasitetit të saj dhe për afrimin me acquis të BE, ka pasur nevojë për përmirësime.

Në këtë kuptim, korniza ligjore e përgatitur nga AKS, është:

- a) Ligji nr. 06/L-019 për standardizim (12.02.2018);
- b) Udhëzimi Administrativ nr. 08/2018 për Këshillin Profesional të Standardizimit (09.08.2018);
- c) Udhëzimi Administrativ nr. 10/2018 për Logon e Agjencisë Kosovare të Standardizimit (15.10.2018);
- d) Udhëzimi Administrativ nr. 16/2018 për Komitete Teknike (27.11.2018).
- e) Nënshkrimi i Marrëveshjes shtesë të bashkëpunimit AKS-TSE (12.11.2018).
- f) Nënshkrimi i marrëveshjes “Licence Agreement” në mes AKS-CEN/CENELEC (14.12.2018).

## **3. Këshilli Profesional i Standardizimit (KPS)**

KPS është trup këshillëdhënës, i cili funksionon në kuadër të AKS dhe si i tillë trajton programet e punës, përbërjen dhe drejtimin e Komiteteve Teknike. KPS mbanë takime të rregullta dy herë në vit, të cilat gjatë vitit 2018 janë mbajtur me 16 janar 2018 dhe 18 qershorit 2018, dhe i njëjti ka shqyrtuar raportin e punës dhe planin e punës për vitin 2018. Gjithashtu me datë 20.12.2018, është thirrur takim për të falënderuar anëtarët e KPS për kontributin e dhënë në standardizimin kosovar.

## **4. Komitetet Teknike (KT)**

Komitete Teknike janë grupe ekspertësh të deleguara nga institucione/organizata të cilat veprojnë në fusha të caktuara të ekonomisë e që janë të përfshirë në procesin e standardizimit, respektivisht në hartimin dhe adoptimin e standardeve.

KT mblidhen në bazë të kërkesave nga palët e interesit dhe si të tilla gjatë vitit 2018 janë mbajtur gjithsejtë 12 takime të ndryshme:

- eurokode (2);
- mjedis (1);
- metrologji (1);
- elektroteknikë (2);
- derivate të naftës dhe gazit (3);
- lodra, pajisje sportive dhe rekreacion (2); dhe
- metale, plastikë dhe elektrikë (1).


## 5. Standardet e adoptuara

AKS në vazhdimësi adopton zhvillon/adopton/miraton standarde të cilat janë me prioritet për ekonominë e vendit, industrinë dhe gjithashtu për legjislacionin me theks të veçantë për rregullore teknike të cilat i referohen standardeve.

Në total janë identifikuar gjithsejtë 587 standarde evropiane EN dhe ndërkombëtare ISO/IEC, të cilat janë adoptuar si standarde kosovare SK:

- ✓ KT për Mjedis (167 SK).
- ✓ KT për Metrologji (1 SK).
- ✓ KT për Elektroteknikë (312 SK).
- ✓ KT për Derivate të Naftës dhe Gazit (74 SK).
- ✓ KT për Lodra, Pajisje Sportive dhe Rekreacion (33 SK).

Tabela 1. Standardet e adoptuara




✓ KT për Metale, Plastikë dhe Elektrikë, me datën 14.12.2018 ka mbajtur takim për shqyrtimin e 9 standardeve, dhe të njëjtat janë hedhur në diskutim publik deri me datën 14.02.2019.

## 6. Standardet e shfuqizuara

Për të siguruar që standardet janë në fuqi, sekretarët e komiteteve teknike në vazhdimësi duhet t'i rishikojnë ato në një periudhë nga një deri në pesë vjet. Standardet mund të rishikohen edhe më shpejt me kërkesë të palëve të interesit, me informacionin për shfuqizim të marrë nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, me ndryshimin e teknologjisë ose ndryshime tjera eventuale.

Në bazë të kësaj, janë identifikuar gjithsejtë 308 standarde kosovare SK të cilat janë shfuqizuar (tabela 2).

Tabela 2. Standardet e shfuqizuara



## **7. Standardet e shitura**

Standardet janë dokumente teknike të cilat zhvillohen në komitete teknike dhe pasi miratohen nga AKS bëhen publike për të gjitha palët e interesit. Çdo kush pastaj mund të blen standarde, e cila bëhet duke identifikuar standardet dhe dërguar kërkesën në adresën [aksinfo@rks-gov.net](mailto:aksinfo@rks-gov.net), ose drejtpërdrejtë në zyrat e AKS ose edhe nëpërmjet telefonit, dhe në momentin kur konfirmohet pagesa e faturës, standardi bëhet i gatshëm për blerësin. Në total gjatë vitit 2018, janë shitur gjithsejtë 65 standarde, në vlerën 1,439.00 €. Kryesisht edhe këtë vit, kërkesat për blerje kanë qenë më të theksuara në standardet e sistemeve të menaxhimit.

## **8. Aktivitete promovuese të AKS**

Zhvillimi i mëtejshëm i politikave dhe programeve të AKS dhe rolit e rëndësishëm të standardeve dhe standardizimit kanë qenë prioritet i AKS. Gjatë këtij viti AKS ka prezantuar në këto evente:

- a) Standardizimi në Kosovë dhe sfidat për rritjen e kualitetit të produkteve vendore (02.03.2018);
- b) Standardet referencë për sigurinë e lodrave (10.05.18);
- c) Roli i IC në Zhvillim Ekonomik (29.05.18);
- d) Fuqizimi i Euro Kodeve (08.06.18);
- e) Efektet e standardizimit të produkteve vendore në maksimizimin e përfitimeve nga MSA” (20.06.2018);
- f) Prezantim i AKS për SHM Hoxhë K. Prishtina (10.09.18);
- g) Prezantim i AKS për SHM Hoxhë K. Prishtina (17.09.18)
- h) Dita Botërore e Standardeve (16.10.18);
- i) Diskutim mbi rregulloret dhe standardet e produkteve në BE (15.11.18);
- j) Roli dhe rëndësia e standardeve për studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike/UP (11.12.2018).
- k) Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ka kënaqësinë dhe nderin t'ju ftojë për një fjalë hyrëse në konferencën për shtyp me temën “Standardizimi i produkteve vendore: Shpërndarja dhe shitja e standardeve” (11.12.2018).

## **9. Sistemi SMIS dhe ueb faqja e AKS**

Sistemi SMIS është zhvilluar dhe avancuar në shkallë të kënaqshme për nevojat e AKS dhe për të gjitha palët e interesit.

Ky sistem shfrytëzohet nga i gjithë stafi (5 sekretarët e komiteteve teknike) dhe përmban aktivitete si:

- Përgatitja e materialeve për futjen e të dhënave në Sistemin e Menaxhimit të Standardeve.
- Identifikimi i materialeve në SMIS që nevojiten për ndryshime.
- Gabimet në futjen e të dhënave në SMIS.
- Krijimi i user name dhe passwordit për palët e interesit.
- Krijimi i linçeve në AKS web.
- Ndryshimet e strukturës vizuale të AKS web.
- Identifikimi i problemeve në SMIS, mos shfaqja e standardeve në ueb të AKS.
- Identifikimi i standardeve të cilat nuk përputhen me çmimet.
- Identifikimi i standardeve të cilat nuk kanë pdf fille në sistem.
- Futja e të dhënave në data bazë dhe identifikimi i standardeve të dublifikuara.
- Identifikimi i standardeve të shfuqizuara.
- Përpilimi i listave në Komitete Teknike me standarde të shfuqizuara.
- Përpunimi i fjalorit terminologjik të standardeve.
- Identifikimi i standardeve të harmonizuara.
- Përpilimi i planit lidhur me direktivat, lista me standarde të harmonizuara dhe filtrimit të tyre sa janë adoptuar nga AKS.

## 10. Buxheti i AKS

Buxheti i AKS-së për mallra dhe shërbime është 30,482.00 €

Kategoritë ekonomike	Buxheti
Shpenzime të udhëtimit	5,250.00 €
Shërbime kontraktuese	16,930.00 €
Shpenzime për anëtarësim	3,000.00 €
Shpenzime të marketingut	4,000.00 €
Shpenzimet e përfaqësimit	1,302.00

Shpenzimi i buxhetit të vitit 2018 nuk është realizuar në shkallë të mjaftueshme, për shkak të zvogëlimit të numrit të standardeve të paguara në DPS (shërbime kontraktuese), dhe mos anëtarësimit të AKS në ISO/IEC dhe CEN/CENELEC (shpenzime për anëtarësim).

## 11. Grupet punuese/komisionet

Zyrtarët e AKS kanë qenë mjaft të angazhuar nëpër grupe punuese dhe komisione të ndryshme brenda dhe jashtë MTI, si:

- Grupi Punues për vlerësimin e kërkesave për vazhdim të autorizimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit

- Grupi Punues për hartimin e draftit fillestar të Udhëzimit Administrativ për Këshillin Profesional të Standardizimit.
- Grupi Punues për hartimin e draftit fillestar të Udhëzimit Administrativ për Logon e AKS.
- Grupi Punues për hartimin e draftit fillestar të Udhëzimit Administrativ për Komitete Teknike.
- Grupi punues në Këshillin e Akreditimit për Vlerësimin e Trupave të Konformitetit.
- Grup Punues për hartimin e draftit fillestar të Udhëzimit Administrativ për Mënyrën e Emërimit të Trupave për Vlerësimin e Konformitetit.
- Grupi Punues për hartimin e Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë.
- Grupi Punues për hartimin e rregullores për shkëmbimin e informacionit për rregullore teknike dhe standarde.
- Grupi Punues dhe komente lidhur me draft metodologjinë kombëtare për kalkulimin e performancës së integruar energjetike të ndërtesave (MMPH).
- Grupi Punues lidhur me Dimensionin e shtatë (7) të Aktit për Biznes të Vogël (Standardizimi dhe aktivitetet e saj).
- Grupi punues për hartimin e rregullores për mënyrën e notifikimit dhe ofrimit të informacioneve mbi rregulloret teknike, procedurat për vlerësimin e konformitetit.
- Grupi punues i Kryeministrisë, për draftimin e Rregulloreve teknike për ujin e pijshëm.
- Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënie, vazhdimin, refuzimin ose revokimin e licencës, të parashtruara nga subjektet që merren me tregtimin e duhanit dhe produkteve të tij.
- Komisioni për vlerësimin e kushteve për autorizimin e subjekteve për verifikimin e konformitetit të mjeteve matëse në Qendrat e Kontrolleve Teknike të Automjeteve.
- Komisioni përzgjedhës i shërbimit civil për pozitën: Zyrtar për Promovim të Standardeve.
- Komisioni përzgjedhës i shërbimit civil për pozitën: Zyrtar për Certifikim.
- Komisioni përzgjedhës i shërbimit civil për pozitën: Udhëheqës i Sektorit për Metale të Çmuara.
- Komisioni për ankesa dhe konteste (konkurse, transfere, koeficiente, etj.) udhëheqje e Komisionit.
- Komisioni për shqyrtimin e ankesave të aplikantëve kundër vlerësimit të komisionit vlerësues (kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve).

- Komisioni për përzgjedhjen e materialeve promovuese për standardizim (vetëdijesimi i palëve të interesit për rolin dhe rëndësinë e standardeve dhe standardizimit).
- Komisioni për vlerësimin dhe emërimin e trupave për vlerësim të konformitetit për fushat e aplikuara të metrologjisë ligjore për verifikimin, shqyrtimin e konformitetit dhe matjeve zyrtare të rrjedhjes së lëngjeve me përjashtim të ujit.
- Komisioni për vlerësimin e kushteve për emërimin e trupave për vlerësimin e konformitetit.
- Komisioni për vlerësimin e konformitetit të ashensorëve dhe komponentëve të tyre të sigurisë.
- Komisioni për inventarizimin e pasurisë jo-financiare në MTI.
- Menaxhim i kontratës OE "ROSA SECURITY" për sigurimin e objekteve të MTI.
- Menaxhim i kontratës lidhur me katalogun e standardeve kosovare 2018.

## **12. Raporte/kërkesa/takime**

AKS në vazhdimësi bënë raportim në baza të rregullta (javore, tremujore dhe vjetore) dhe shqyrtim të kërkesave për të gjitha palët e interesit, si:

- PKZMSA-Matrica për raportim K1-K4 2018;
- Kapitulli 1-Lëvizja e Lirë e Mallrave; Annex 9-Acquis Ch1;
- PVPQ K1-K4-2018;
- PRE 2018-2020,
- Rishikimi i masave për fushën e Infrastrukturës së Cilësisë-Integrimi Tregtar; Programit për Reforma në Ekonomi.
- Raportim për projektin SIDA (freskim i raportit të 2016)
- Janë realizuar dy takime të Projektit të Qarkullimit të lirë të mallrave FMG (Steering committee) të cilat i ka moderuar Drejtori i Përgjithshëm i AKS, në cilësi të Udhëheqësit të SC të projektit FMG II.

Gjithashtu, AKS ka shqyrtuar shumë kërkesa të ndryshme të palëve të interesit:

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit (MMPH); Drejtoria e Akreditimit; Agjencia e Metrologjisë; Inspektorati; Divizioni për Turizëm; Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"; Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave; OLTi, SHPK; INKOS; "Stewart Inspect" (Trup inspektuese për ashensorë, vinça dhe transportues); LIFT KOS; Kolegji "UBT"; Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës; Oda Ekonomike Amerikane; IMK Ballkan Projekt, SHPK; Kosovo Banking Association; Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, etj.



### **13. Trajnimet/konferencat/marrëveshjet**

- Asambleja Gjenerale e ISO/IEC.
  - Asambleja Gjenerale e CEN/CENELEC.
  - Konferenca Ballkanike e Standardizimit.
  - Konferenca Ballkanike e Teknologjisë Informative për Standardizim.
  - Instituti Austriak i Standardeve.
  - Standardizimi dhe CPR.
  - Fuqizimi i Eurokodeve.
  - Nënshkrim i Memorandumit të mirëkuptimit me Institutin Turk të Standardizimit (TSE).
- Draftim i Marrëveshjes së re me DPS, e cila do të nënshkruhet sapo të vjen përgjigjja nga CEN/CENELEC (Marrëveshja e Licencuar për qasje në EN).

### **14. Ngecjet në realizimin e aktiviteteve**

AKS nëpërmjet SMIS ka planifikuar të realizon shitjen on-line të standardeve, nëpërmjet mbështetjes së projektit FMG. Autoriteti bankar ka konfirmuar që ende nuk mund të realizohet një hap i tillë përderisa të mos kalon ligji për nënshkrim elektronik. AKS ka arrit që të shërbej elektronikisht klientët (standardi mund të shkarkohet në PC e klientit për një print) mirëpo fatura për pagesën e standardit duhet të dorëzohet paraprakisht në AKS. Organogrami i AKS sipas Rregullores për strukturim të MTI-së, nuk është realizuar për shkak të MF që nuk lejon rritje të koeficienteve të zyrtarëve, për të plotësuar (ligjërisht) pozitat e shefave të sektorëve të planifikuar në AKS. Realisht, Agjencia funksionon sipas Rregullores, mirëpo zyrtarët nuk paguhet për pozitat që mbulojnë.

### **15. Sfidat e standardizimit kosovar**

Ndërtimi i Sektorit të Certifikimit në AKS. Fuqizimi i Projektligjit, duhet të pason me një UA për certifikim, për të cilin duhet mirëkuptim i MF. Certifikimin e ka rekomanduar Komisioni Parlamentar si domosdoshmëri kohe, ndërsa AKS pritët ta zhvillon këtë sektor. Gjithashtu, janë edhe disa rregulla dhe procedura të standardizimit të cilat duhet të hartohen konform ligjit të ri për standardizim.

- Ngritja e Sistemit të Menaxhimit për Agjencinë (AKS) mbetet sfidë tjetër e cila duhet të realizohet.
- Ngritja e një pike ose qendre e informacionit për standarde (Info Centre) për të gjitha palët e interesit.
- Anëtarësimet në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare, nuk janë realizuar, për shkaqe politike. AKS ka kërkuar nga CEN/CENELEC një qasje në standardet EN me ç'rast është propozuar një "Marrëveshje e Licencuar".

## **16. Planifikimi i planit të punës AKS 2019**

- Hartimi i rregulloreve të brendshme lidhur me rregullat dhe procedurat e standardizimit.
- Organizim i dy takimeve të Këshillit Profesional të Standardizimit (KPS) sipas UA 08/2018 (janar-qershor 2019).
  - Ngritje e tri nën komiteteve për Eurokode dhe Struktura.
  - Organizim i rreth 15 takimeve të komiteteve teknike.
  - Adoptimi i rreth 500 standardeve të reja.
  - Shfuqizimi i rreth 500 standardeve të vjetra.
  - Manifestim i Ditës Botërore të Standardeve.
  - Pjesëmarrje në asamblatë e përgjithshme të standardeve, evropiane dhe ndërkombëtare.
- Ngritje e kapaciteteve të AKS-së, plotësim i organogramit të planifikuar.
- Organizimi i takimeve me Odat Ekonomike (fushatë promovuese).
- Konsulencë mbi implementimin e standardeve, shërbim i palëve me standarde.
- Pjesëmarrje në iniciativat rajonale dhe evropiane të standardizimit.
- Përgatitje e bazës për ngritjen e certifikimit.
- Identifikim i standardeve të harmonizuara (sipas kërkesës së direktivave në transpozim).
- Bashkëpunim me të gjitha ministritë e linjës dhe institucione tjera që i referohen standardeve.
- Bashkëpunim me të gjithë të interesuarit (KIESA; OEK; OEA, etj.) lidhur me sesione informativ për rolin dhe rëndësinë e standardeve, etj.